



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkjmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Abdülhadi Krasniç, Kryetari i Komunës
Adresa: Rr. "Saat Kule", Mamushë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mamushës (KM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet që kanë ndikuar në opinionin e auditimit janë:

- B1 Komuna nga kategoria e investimeve kapitale kishte realizuar pagesa në vlerë totale prej 191,266€, për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu edhe pagesat në vlerë prej 10,956€ janë realizuar dhe prezantuar si shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, edhe pse për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.
- B2 Regjistri i pasurisë kapitale nuk është i plotë sepse nuk janë regjistruar pasuritë në vlerë prej 324,756€ si blerje nga kategoria e investimeve kapitale. Komuna në regjistrin kontabël/SIMFK po ashtu nuk ka arrite të regjistroj edhe 47 parcela kadastrale, pesë automjete me vlerë të përgjithshme prej 105,305€ dhe 12 automjete funksionale pa vlerë neto në libra, pasuri të përfituar në të kaluarën. Më tutje, nuk janë evidentuar në regjistrin kontabël në SIMFK edhe ndërtesat e shkollave, donacion të trashëguara, ndërtesa komunale dhe ndërtesa e QMF-së.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Mamushës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mamushës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mamushës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mamushës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë,

por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mamushës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mamushës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" specifikon se "Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Po ashtu me të njëjtën rregullore, neni 33 pagesat përmes listës së pagave paragrafi 1 specifikon se organizatat buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave.

- Komuna nga kategoria e investimeve kapitale kishte realizuar pagesa në vlerë totale prej 191,266€, për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Komuna është futur në obligim kontraktuale, duke lidhur aneks marrëveshje[*], të titulluar si projekt për "Shëndet dhe mirëqenie sociale, edukim dhe ambient të pastër për të gjithë" me një OJQ me dt.21.12.2020, në vlerë prej 191,266€, ku një pjesë e fondeve është destinuar për implementimin e projektit (99,466€) për përkrahje e qytetarëve me pako ushqimore dhe higjienike dhe pjesa tjetër (91,800€) ishte dedikuar për çdo nxënës që regjistrohet në vitin shkollor 2020/2021 nga 100€ sipas numrit të regjistruar të nxënësve. Bazuar në këtë aneks marrëveshje Komuna ka realizuar pagesat me dt.22.12.2020 në llogarinë e OJQ në vlerë prej 96,266€ dhe 95,000€ duke shfrytëzuar mjetet që ishin buxhetuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2020 nr.07/L-001 për projektin me nr. 50220- "Ndërtimi i Aneksit të Shkolla Fillore" në vlerë prej 191,266€, dhe të njëjtat shpenzime i ka regjistruar në kodin ekonomik 31121 - objektet arsimore.

Transferi i mjeteve ishte aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo ky transfer nuk ishte realizuar edhe nga Ministria e Financave edhe pse Kryetari kishte kërkuar. Komuna këtë vendim e mbështet me mungesën e buxhetit për kategorinë adekuate ekonomike.

- Po ashtu, edhe pagesat në vlerë prej 10,956€[*] janë realizuar dhe prezantuar si shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, edhe pse për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Pagesat ishin realizuar për paga si në vijim: Me vendim të Kryetarit janë paguar pagat e zyrtarëve të angazhuar si stafi politik, mëditje, tatimet dhe kontributet. Pra i gjithë shpenzimi ishte regjistruar dhe prezantuar tek mallrat dhe shërbimet, si shërbime të ndryshme intelektuale (kodi ekonomik 13440), ku 7,314€ janë shpenzime që realisht i takonin pagave për stafin politik, në emër të tatimit janë paguar 306€, në emër të kontributeve janë paguar 836€ dhe 2,500€ mëditje për takimet e mbajtura, për anëtarët e Komitetit komunal për siguri në bashkësi.

Kjo ka ndodhur për arsye se Komuna nuk ka paraparë me buxhet mjete financiare për stafin mbështetës të Kryetarit, Nënkryetarit dhe Kryesuesit të komunës në kategorinë ekonomike adekuate.

Ndikimi

Kjo ndikon në nënvlerësimin/mbivlerësimin e shpenzimeve nëpër kategori, duke rrezikuar arritjen e projeksioneve të buxhetuara dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkesat sipas nevojave të planifikohen drejt dhe shpenzimet të realizohen në kategoritë përkatëse ekonomike. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e Komunës, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për fuqizimin e kontrollit për planifikimin, pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Neni 6 i Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare nr.02/2013 përcakton që: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Edhe pse kemi një ndryshim pozitivë krahas vitit paraprak, Komuna nuk kishte arritur ta plotësoj regjistrin e pasurisë mbi 1,000€ në SIMFK, si në vijim:

- Nga blerjet e investimeve kapitale në vitin 2020 në vlerë prej 646,160€ vetëm gjashtë transaksion janë regjistruar me vlerë prej 130,138€, pjesa tjetër në vlerë prej 324,756€ nuk është regjistruar ende (analiza është bazuar në blerjet nga kapitalet duke përfshirë keq klasifikimet, 191,266€); dhe
- Objektet/shkollat donacion, të trashëguara, objektet komunale, dhe ndërtesa e QMF-së nuk ishin regjistruar në regjistrin përkatës. Nuk ishin regjistruar autoambulanca në vlerë 38,340€ donacion, katër automjete në vlerë totale 66,965€ dhe 12 automjete pa vlerë neto në libra por që janë funksionale. Asnjëra nga gjithsej 47 prona Kadastrale (parcela) nuk ishin regjistruar ende.

Sipas Rregullorës së njëtit neni 19 pika 4.3 është përgjegjësi e komisionit të inventarizimit që të bëjë edhe: “Krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”. Gjithashtu edhe pika 4.7 përcakton se “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”.

Kemi identifikuar dobësi si në vijim:

- Komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin por nuk është kryer krahasimi i informatave me regjistrat e pasurisë jo financiare; dhe
- Komuna kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurisë, ky komision kishte përgatitur një raport ku kishte vlerësuar pasurinë e Komunës duke i dhënë vlerë secilës prej tyre. Mirëpo komisioni nuk ishte në gjendje ta arsyetoj këtë vlerësim për shkak se mungojnë dëshmitë/faktet si faturat, kontratat, marrëveshjet etj. për pasuritë që ishin në posedim të Komunës si pasuri e trashëguara, blerë

(deri në vitin 2019), apo e përfituara nga donatorët dhe nga bashkëfinancimet. Ky raport është përgatitur me qëllim që kjo pasuri të regjistrohet në SIMFK mirëpo ende Komuna nuk ka arritur ti bëjë regjistrimet e duhura.

Kjo gjendje është rezultat i mungesës së mekanizmit të kontrollit të brendshëm, i kujdesit jo të duhur, dhe kompetencës jo të duhur të zyrtarit të pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë ndikon në prezantimin jo të drejt të pasurisë duke çorientuar shfrytëzuesit e PVF-ve dhe kjo njëherit rrezikon përvetësimin apo keq menaxhimin e pasurive të Komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj se harmonizimi midis raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël bëhet para përgatitjes së PFV për vitin 2021.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 781,812€, prej tyre ishin shpenzuar 646,160€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime për objekte shkollore, ndërtimin e rrugëve dhe kanalizime .Kemi testuar 25 mostra për teste substanciale në vlerë 584,536€, si dhe 4 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Parregullsi në menaxhimin e kontratës

Gjetja

Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik si dhe rregullat dhe udhëzuesi për prokurimin publik (RRUOP), përcaktojnë kriteret për menaxhimin e kontratës. Sipas pikës 61.19 (b) të RRUOPP një nder përgjegjësitë e menaxherit të projektit është edhe që të “sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë”.

Gjatë ekzaminimit fizik të punëve në teren të projektit sipas kontratës për “Shtrimi i rrugëve lokale me kubëza në Komunën e Mamushës” në vlerë prej 124,449€, kemi vërejtur që ishin pranuar dhe paguar punë të cilat nuk ishin realizuar.

Nga 48 rrugë të paguara përmes kësaj kontrate ne kemi ekzaminuar katër prej tyre (rruga Nazmi Tac, Cemal Krasnic, Turhan Mazrek dhe Speytim Mazrek) dhe gjatë ekzaminimit fizik kemi identifikuar se për pozicionet e verifikuara:

- Komuna kishte paguar 63m³*2€ apo 126€, punë që nuk ishin realizuar fare në katër rrugët e ekzaminuara, të faturuara sipas pozicionit nr. 2.4 të ofertës financiare të kontraktuar, “Punimi i bankinave me trashësi 25cm dhe gjerësi 0.50m me material zhavorri me fraksion 0-32mm”.
- Komuna kishte paguar sasi e cila nuk ishte realizuar 42m³*3.5€ apo 147€ sipas pozicionit të ofertës financiare nr. 3.5 (Furnizimi dhe montimi i gurëve skajor me dimensione 110/20/100cm), në rrugët (Esat Mazrek 26m dhe Shpejtim Mazrek 16m);
- Komuna kishte paguar 10 copë*15 apo 150€ sasi e cila nuk ishte realizuar sipas pozicionit të ofertës nr. 3.7 (Ngritja dhe nivelizimi i pusetave ekzistuese dhe furnizimi dhe montimi i kapakëve metalik 40t). Ky pozicion gjendet në rrugët: Çemajl Krasniqi 2 copë, Fazli Mazrek 4 copë dhe Shpejtim Mazrek 4 copë.

Komuna deklaroi se këto punë janë zëvendësuar me zëra tjerë sipas kërkesave në terren edhe pse nuk janë evidentuar në raportin e pranimit, kjo për shkak të planifikimit jo të drejt të kërkesave fillestare.

Ndikimi

Dobësitë me rastin e pranimit të punëve jo në përputhje me sasi të realizuar nga komisioni i pranimit dhe menaxheri i kontratës rezultoi me pagesa të parregullta për punët të cilat nuk janë kryer sipas kontratës dhe dëmton buxhetin e komunës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se planifikim i kërkesave të behet sipas nevojave reale, dhe komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB. Komuna me dt.24.10.2019 kishte parashtruar kërkesë për auditim të brendshëm drejtuar Njësisë për Auditim të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave. NjAB pran MF kishte pranuar kërkesën, mirëpo deri në përfundimin e auditimit nga ZKA, procesi i auditimit të brendshëm ende nuk ishte përfunduar.

Çështja A2 - Mos sigurimi i shërbimit të auditimit të brendshëm

Gjetja Ligji nr. 06 / L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Rregulloren e QRK-së nr. 01/2019 për krijimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, nenet 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB-së. Bazuar në nenin 5 “ Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3.000.000€) milionë euro, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3. dhe 1,4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. (themelimin e një njësi të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, me miratimin/ aprovimin paraprak të MF).

Komuna gjatë vitit 2020 nuk është audituar edhe pse e ka dërguar një kërkesë në MF me dt. 24.10.2019 për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Kjo për shkak se nuk janë bërë përpjekje për themelimin e një njësi të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, miratimit/ aprovimit paraprak të MF.

Ndikimi Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm shpie në përsëritjen e vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për t'i eliminuar ato.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,968,887.40	2,358,481.12	2,187,392.43	1,966,586.07	2,265,753.26
Grante Qeveritare – Buxheti	1,905,690.40	2,211,863.09	2,100,287.96	1,880,385.52	2,171,302.94
Financimi përmes huamarrjes	0.00	28,036.40	22,706.52	0.00	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	44,015.73	32,093.74	59,844.30	67,856.97
Të hyrat vetanake	63,197.00	63,197.00	21,043.21	25,969.25	17,103.35
Donacionet vendore	0.00	0.20	0.00	0.00	500.00
Donacionet e jashtme	0.00	11,368.70	11,261.00	387.00	8,990.00

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 389,594€. Kjo rritje është rezultat i huamarjeve nga banka botërore, alokimit të mjeteve në komuna për rimëkëmbje ekonomike sipas vendimeve qeveritare, bartjes së të hyrave nga viti i kaluar, donacioneve dhe transferit të rezervës.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar ose 2,187,392€ në të njëjtin nivel me vitin e kaluar, sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,968,887.40	2,358,481.12	2,187,392.43	1,966,586.07	2,265,753.26
Pagat dhe mëditjet	1,064,241.00	1,128,240.05	1,127,519.84	993,287.26	897,585.60
Mallrat dhe shërbimet	317,426.00	364,928.97	356,912.80	253,313.24	218,930.30
Komunalitë	31,000.00	31,000.00	30,999.75	30,178.12	24,036.62
Subvencionet dhe transferet	28,500.00	52,500.00	25,800.00	27,834.40	406,037.00
Investimet Kapitale	455,938.40	781,812.10	646,160.04	661,973.05	719,163.74
Rezervat	71,782.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Rritja e buxhetit të pagave dhe mëditjeve për 63,999€ është një reflektim i pagave shtesë për zjarrfikësit, inspektorëve komunal dhe stafit shëndetësorë me vendimet e Qeverisë për shkak të situatës pandemike. Buxheti final është realizuar në tërësi.
- Rritja në buxhetin final për mallrave dhe shërbime për 47,503€ është rezultat i huamarrjes (projekt i financuar nga Banka Botërore), rimëkëmbjes ekonomike, transferit nga rezerva, granteve të donatorëve përderisa shpenzimet komunale nuk kanë ndryshuar. Buxheti final është realizuar 98% ndërsa buxheti për shpenzime komunale është realizuar në tërësi.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 24,000€ krahas buxhetit fillestar si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake nga viti i kaluar për të njëjtën shumë. Realizimi për këtë kategori është vetëm 49% e buxhetit final dhe kjo për arsye të vështirësis për shkak të gjendjes pandemike.
- Rritja e buxhetit final në investime kapitale për 325,874€ është rezultat i huamarrjes nga Banka botërore për projektin përmirësimi i sistemit të arsimit në Kosovë, mjeteve të alokuara nga komuna për rimëkëmbjes ekonomike, transferit të mjeteve nga rezerva, granteve dhe donacioneve të bartura ndër vite dhe të hyrave të bartura nga viti i kaluar. Realizimi për këtë kategori është 83% e buxhetit final.

Për shkak të situatës pandemike me Covid – 19 Komuna e Mamushës kishte shpenzuar buxhet të ndarë për këtë qëllim në vlerë totale prej 91,876€, prej të cilave 49,560€ ishin shtesa në paga dhe mëditje dhe 42,316€ për mallra e shërbime.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna e Mamushës kishte realizuar të hyra në vlerë 51,622€, apo 81% krahasuar me planifikimin e vitit 2020. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak realizimi i të hyrave ka pësuar rënie për 14%.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	63,197.00	63,197.00	51,622.08	60,688.38	56,177.06
Të hyrat tatimore	32,690.00	32,690.00	23,833.48	26,752.88	29,009.06
Të hyrat jo tatimore	30,507.00	30,507.00	27,788.60	33,935.50	27,168.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 për Komunën e Mamushës ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, shtatë rekomandime janë zbatuar, dy nuk janë zbatuar, një rekomandim konsiderohte si i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.	Nuk janë ndërmarr veprime të mjaftueshme	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitimin me kohë të të hyrave të mbledhura nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.	Nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit respektohen të gjitha kriteret e vendosura në konkurs. Në të kundërtën, në mungesë të konkurrentëve të rishpallat konkursi.	Nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që në thirrjet publike për subvencionimin e OJQ-ve të vendosen kritere të përgjithshme obligative dhe të lidh kontrata me OJQ-të e përzgjedhura si përfituesi.	Nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para se të realizoj punimet për projektet të cilat shtrihen përgjatë parcelave të cilat janë nën pronësi private, të ndërmarr veprimet e duhura ligjore për shpronësimin e parcelave përkatëse të cilat komuna i sheh në interes të publikut.	Nuk janë identifikuar raste të reja mirëpo rastet e identifikuar vitin e kaluar nuk janë zgjidhur.	Nuk është aplikueshëm më
6.	Investimet kapitale	Kryetari përmes Menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejohet inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv, gjithashtu nuk duhet të lejohen tejkalime-ndryshime të pozicioneve të paramasave paraprakisht të kontraktuara, sepse çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës. 12	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para marrjes së vendimit për bartje të shumave nga një projekt në tjetrin, duhet miratimi paraprak nga Kuvendi Komunal.	Nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të	Nuk janë ndërmarr veprime të	Nuk ka filluar zbatimin

		plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit të inventarizimit, për harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël dhe komisionet e vlerësimit të krijohen në kohën e duhur me qëllim që gjendja e saktë e pasurisë të pasqyrohet drejt në PFV.	mjaftueshme	
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.	Janë hartuar rregullat e brendshme	I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë identifikuar raste të reja.	I zbatuar

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.
2.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit të inventarizimit, për harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël dhe komisionet e vlerësimit të krijohen në kohën e duhur me qëllim që gjendja e saktë e pasurisë të pasqyrohet drejt në PFV.
4.	Auditimi Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Muhamet Balaj, Udhëheqës i ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Gjatë ekzaminimit fizik të punëve në teren të projektit sipas kontratës për “Shtrimi i rrugëve lokale me kubëza në Komunën e Mamushës” në vlerë prej 124,449€, kemi vërejtur që ishin pranuar dhe paguar punë të cilat nuk ishin realizuar.</p> <p>Nga 48 rrugë të paguara përmes kësaj kontrate ne kemi ekzaminuar katër prej tyre (rruga Nazmi Tac, Cemal Krasnic, Turhan Mazrek dhe Speytim Mazrek) dhe gjatë ekzaminimit fizik kemi identifikuar se për pozicionet e verifikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> Komuna kishte paguar 63m³*2€ apo 126€, punë që nuk ishin realizuar fare në katër rrugët e ekzaminuara, të faturuara sipas pozicionit nr. 2.4 të ofertës financiar të kontraktuar, “Punimi i bankinave me trashësi 25cm dhe gjerësi 0.50m me material zhavorri me fraksion 0-32mm”. Komuna kishte paguar sasi e cila nuk ishte realizuar 42m³*3.5€ apo 147€ sipas pozicionit të ofertës financiare nr. 3.5 (Furnizimi dhe montimi i gurëve skajor me dimensione 110/20/100cm), në rrugët (Esat Mazrek 26m dhe Shpejtim Mazrek 16m); Komuna kishte paguar 10 copë*15 apo 150€ sasi e cila nuk ishte realizuar sipas pozicionit të ofertës nr. 3.7 (Ngritja dhe nivelizimi i pusetave ekzistuese dhe furnizimi dhe montimi i kapakëve metalik 40t). Ky pozicion gjendet në rrugët: Çemajl Krasniqi 2 copë, Fazli Mazrek 4 copë dhe Shpejtim Mazrek 4 copë. 	<p>Çështja A1 është dashur të trajtohet si e gjetur ndërmjet menaxhmentit tuaj duke diskutuar me zyrtarët komunal për të cilën nga profesionistët lexohet drejt dhe nga jo profesionistët lexohet dhe komentohet sipas konotacionit të dëshiruar për çështje politike apo personale dhe në rastin konkret shumat e cekura në këtë të gjetur ka mundësi të dëmtohet institucioni së bashku me zyrtarë pasi që nuk është cekur që kontrata si tërësi është realizuar sepse për palët e treta jep të kuptojë që operatori ekonomik ka përfituar pa realizuar punimet.</p>	<p>Komenti juaj nuk qëndron sepse konformë Standardeve Nderkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) është auditori ai i cili përdorë gjykimin profesional lidhur me dërgimin e një gjetje përmes raportit apo letër menaxhmentit. Vetëm çështjet me prioritet të ulët sipas gjyimit profesional të auditorit janë subjekt i vendosjes në letër menaxhment ndërsa në rastin konkret nga 48 rrugë kemi zgjedhur vetëm katër për ekzaminim fizik ku janë evidentuar gjetje prandaj edhe është vendosur në raportin e auditimit. Gjetja jonë e prezantuar në raport mbetet e pandryshuar.</p>
<ul style="list-style-type: none"> Komuna nga kategoria e investimeve kapitale kishte realizuar pagesa në vlerë totale prej 191,266€, për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së 	<p>Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet sipas standardeve Nderkombëtare të Kontabilitetit për</p>	<p>Komenti i juaj nuk qëndron për arsye se keqklasifikimet në institucionin tuaj për dallim nga komunat tjera ku ju</p>

<p>mallrave dhe shërbimeve. Komuna është futur në obligim kontraktuale, duke lidhur aneks marrëveshje[*], të titulluar si projekt për “Shëndet dhe mirëqenie sociale, edukim dhe ambient të pastër për të gjithë” me një OJQ me dt.21.12.2020, në vlerë prej 191,266€, ku një pjesë e fondeve është destinuar për implementimin e projektit (99,466€) për përkrahje e qytetarëve me pako ushqimore dhe higjienike dhe pjesa tjetër (91,800€) ishte dedikuar për çdo nxënës që regjistrohet në vitin shkollor 2020/2021 nga 100€ sipas numrit të regjistruar të nxënësve. Bazuar në këtë aneks marrëveshje Komuna ka realizuar pagesat me dt.22.12.2020 në llogarinë e OJQ në vlerë prej 96,266€ dhe 95,000€ duke shfrytëzuar mjetet që ishin buxhetuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2020 nr.07/L-001 për projektin me nr. 50220-“Ndërtimi i Aneksit të Shkolla Fillore” në vlerë prej 191,266€, dhe të njëjtat shpenzime i ka regjistruar në kodin ekonomik 31121 - objektet arsimore.</p> <p>Transferi i mjeteve ishte aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo ky transfer nuk ishte realizuar edhe nga Ministria e Financave edhe pse Kryetari kishte kërkuar. Komuna këtë vendim e mbështet me mungesën e buxhetit për kategorinë adekuate ekonomike.</p> <ul style="list-style-type: none"> Po ashtu, edhe pagesat në vlerë prej 10,956€[*] janë realizuar dhe prezantuar si shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbime, edhe pse për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Pagesat ishin realizuar për paga si në vijim: Me vendim të Kryetarit janë paguar pagat e zyrtarëve të angazhuar si stafi politik, mëditjet për asambleist, tatimet dhe kontributet. Pra i gjithë 	<p>rekomandimin: çështja B1 dhe çështja B2. Dhe kam koment për të cilin nuk pajtohem me opinionin e kualifikuar pasi që raportet e publikuara në faqen zyrtare të ZKA për të gjeturat e njëjta ku keni dhënë mendim/opinion të pakualifikuar për shumë komuna dhe në këtë rast ka trajtim jo të barabart ndermjet etniteteve në nivel lokal dhe kërkojmë të ndryshohet opinionin.</p>	<p>jeni referuar nuk kanë ndodhur si rezultat i keqbuxhetimit/planifikimit të gabuar apo/dhe si rezultat i vendimeve gjyqësore apo/dhe pagesave direkte. Ato janë shkaktuar nga vet komuna gjatë procesit të shpenzimit të mjeteve prandaj edhe niveli i tyre është material dhe me ndikim në pasqyrat financiare. Gjetja jonë e prezantuar në raport mbetet e pandryshuar.</p>
--	---	---

<p>shpenzimi ishte regjistruar dhe prezantuar tek mallrat dhe shërbimet, si shërbime të ndryshme intelektuale (kodi ekonomik 13440), ku 7,314€ janë shpenzime që realisht i takonin pagave për stafin politik, në emër të tatimit janë paguar 306€, në emër të kontributeve janë paguar 836€ dhe 2,500€ mëditje për takimet e mbajtura, për anëtarët e Komitetit komunal për siguri në bashkësi.</p>		
<p>Edhe pse kemi një ndryshim pozitivë krahas vitit paraprak, Komuna nuk kishte arritur ta plotësoj regjistrin e pasurisë mbi 1,000€ në SIMFK, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga blerjet e investimeve kapitale në vitin 2020 në vlerë prej 646,160€ vetëm gjashtë transaksion janë regjistruar me vlerë prej 130,138€, pjesa tjetër në vlerë prej 324,756€ nuk është regjistruar ende (analiza është bazuar në blerjet nga kapitalet duke përjashtuar keq klasifikimet, 191,266€); dhe Objektet/shkollat donacion, të trashëguara, objektet komunale, dhe ndërtesa e QMF-së nuk ishin regjistruar në regjistrin përkatës. Nuk ishin regjistruar autoambulanca në vlerë 38,340€ donacion, katër automjete në vlerë totale 66,965€ dhe 12 automjete pa vlerë neto në libra por që janë funksionale. Asnjëra nga gjithsej 47 prona Kadastrale (parcela) nuk ishin regjistruar ende. <p>Sipas rregullorës së njëti neni 19 pika 4.3 është përgjegjësi e komisionit të inventarizimit që të bëjë edhe: "Krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare". Gjithashtu edhe pika 4.7 përcakton se "Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare</p>	<p>Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet sipas Standardeve Nderkombëtare të Kontabilitetit për rekomandimin: çështja B1 dhe çështja B2. Dhe kam koment për të cilin nuk pajtohem me opinionin e kualifikuar pasi që raportet e publikuara në faqen zyrtare të ZKA për të gjeturat e njëjta ku keni dhënë mendim/opinion të pakualifikuar për shumë komuna dhe në këtë rast ka trajtim jo të barabart ndërmjet etnitetëve në nivel lokal dhe kërkojmë të ndryshohet opinionin.</p>	<p>Komenti juaj nuk qëndron duke pasur parasysh komentin tonë më lartë lidhur me çështjen B1 dhe meqenëse llogaria e pasurisë kapitale në pasqyra financiare nuk është e plotë dhe e saktë në një vlerë materiale për të cilin ju jeni pajtuar, ndërsa në përputhje me (SNISA 700, 705, 706), ZKA shprehë opinionin e auditimit. Gjetja jonë e prezantuar në raport mbetet e pandryshuar.</p>

<p>në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”.</p> <p>Kemi identifikuar dobësi si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin por nuk është kryer krahasimi i informatave me regjistrat e pasurisë jo financiare; dhe • Komuna kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurisë, ky komision kishte përgatitur një raport ku kishte vlerësuar pasurinë e Komunës duke i dhënë vlerë secilës prej tyre. Mirëpo komisioni nuk ishte në gjendje ta arsyetoj këtë vlerësim për shkak se mungojnë dëshmitë/faktet si faturat, kontratat, marrëveshjet etj. për pasuritë që ishin në posedim të Komunës si pasuri e trashëguara, blerë (deri në vitin 2019), apo e përfituara nga donatorët dhe nga bashkëfinancimet. Ky raport është përgatitur me qëllim që kjo pasuri të regjistrohet në SIMFK mirëpo ende Komuna nuk ka arritur ti bëjë regjistrimet e duhura. 		
--	--	--



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet sipas Standardëve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për rekomandimin: Çështja B1 dhe Çështja B2.
Dhe kam koment për të cilin nuk pajtohem me opinionin e kualifikuar pasi që raportet e publikuara në faqën zyrtare të ZKA për të gjeturat e njëjta ku keni dhënë mendim/opinionin të pakualifikuar për shumë komuna dhe në këtë rast ka trajtim jo të barabartë ndërmjet etniteteve në nivel lokal dhe kërkojmë që të ndryshohet opinionin. Ndërsa rekomandimi: Çështja A1 është dashur të trajtohet si e gjetur ndërmjet menaxhmentit Tuaj duke u diskutuar me zyrtarët komunal për të cilën nga profesionistët lexohet drejtë dhe nga jo profesionistët lexohet dhe komentohet sipas konatacionit të dëshiruar për qështje politike apo personale dhe në rastin konkret shumat e cekura në këtë të gjetur ka mundësi të dëmtohet institucioni së bashku me zyrtarë pasi që nuk është cekur që kontrata si tërësi është realizuar sepse për palët e treta jep të kuptojë që operatori ekonomik ka përfituar pa realizuar punimet.
Çështja A2 pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Abdullhadi Krasniç

Kryetar i Komunës së Mamushës

Data: 21.07.2021, Mamushë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 Ky aneks është bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimi për “Shëndet dhe mirëqenie sociale për të gjithë” me të njëjtën OJQ (dt.08.10.2020 në vlerë prej 204,435€ ku Komuna ka participuar me 163,535€), e cila fushëveprim kishte kujdesin shëndetësor në shtëpi dhe QMF, edukimin shëndetësor dhe mjedisor, kujdesin social dhe edukativo arsimor. Sipas mostrës së audituar në gjashtë raste kemi gjetur se për asistent adm. në zyrën e Nënkryetarit paga 382€ bruto; zyrtar adm. në zyrën e Kryetarit paga 328€ bruto, pagesat për mëditjet e mbledhjes me date 23.12.19 dhe 18.02.20 për anëtarët e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi/13 anëtar në vlerë prej 1300€, paga jubilarë për zyrtarin në zyrën për Komitet dhe kthim 97€; zyrtar adm. në zyrën e Kryetarit 455€ bruto zyrtar i Zyrës së Kryesuesit të K.K. paga 280€ bruto.
- 6 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 7 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 8 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.